



ODA E ARKITEKTËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS



KOMUNA Shtime

MEMORANDUM I BASHKËPUNIMIT

I LIDHUR
NDËRMJET

KOMUNËS SHTIME
DHE
ODËS SË ARKITEKTËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS (OARK)

PARATHËNIE

Duke u bazuar në vullnetin e përbashkët për bashkëpunim ndërmjet institucioneve publike dhe organizatave profesionale për ngritjen e cilësisë së planifikimit dhe zhvillimit urban;

Duke pasur në konsideratë nevojën për organizimin e konkurseve të projektimit në përputhje me standardet më të larta profesionale, ngritjen e kapaciteteve profesionale në mbikëqyrjes së projekteve dhe procedurat e pajisjes me leje ndërtimore,

Duke marrë parasysh rolin e Odës së Arkitektëve të Republikës së Kosovës (OARK) si trupi i vetëm profesional i arkitektëve në Kosovë, i rregulluar me ligj dhe përgjegjës për standardet etike dhe profesionale të profesionit,

Duke pasur parasysh nevojën për bashkëpunim institucional dhe profesional për cilësinë e zhvillimit urban, palët bien dakord për këtë Memorandum si më poshtë:

NENI 1 – QËLLIMI

Ky memorandum ka për qëllim të vendosë bazat për bashkëpunim në fushën e planifikimit hapësiror, arkitekturës dhe zhvillimit urban të qëndrueshëm në Komunën e Shtime, duke shfrytëzuar ekspertizën e OARK-së dhe vullnetit të Komunës së Shtime për të siguruar zbatimin e praktikave më të mira në këto fusha:

- Hartimin e planeve strategjike, multidisiplinare e gjithpërfshirës Komunale,
- Organizimin dhe zhvillimin e konkurseve profesionale për projektim arkitektonik dhe urban;
- Hartimi i kriterëve profesionale për projektet dhe konkurset publike;



- Promovimin e transparencës, profesionalizmit dhe cilësisë në fushën e arkitekturës dhe urbanizmit në Komunën e Shtime si dhe zbatimi i standardeve etike në proceset urbane;
- Ofrimit të asistencës dhe ekspertizës profesionale sipas nevojës.
- Zhvillimin e projekteve të përbashkëta që synojnë përmirësimin e infrastrukturës publike dhe cilësisë së jetesës në Komunën e Shtime.

NENI 2 – DETYRIMET E PALËVE

Komuna e Shtime dhe OARK do të bashkëpunojnë në fushën e arkitekturës, urbanizmit dhe planifikimit hapësior, duke siguruar transparencë dhe cilësi të lartë profesionale

2.1 Detyrat e OARK-së

1. Asistencë Teknike:

- Ofron ekspertizë për hartimin e PZHK, HZ, PHRRU dhe vlerësimin e aplikacioneve për leje ndërtimi;
- Monitoron zbatimin e kriterëve profesionale në projekte;
- Rekomandon ndërhyrje administrative nëse identifikon shkelje.
- OARK angazhohet të organizojë aktivitetet edukative dhe trajnuese për komunitetin profesional dhe publikun e Komunës së Shtime.

2. Konkursat e Projektimit:

- Harton kriteret teknike dhe estetike për konkursat e projektimit, në përputhje me standardet ndërkombëtare;
- Cakton përfaqësues në komisionet vlerësuese apo grupet punuese duke garantuar paanshmëri dhe shmangie të konfliktit të interesit në përputhje me ligjin e prokurimit.
- Përfaqësuesit e OARK-së janë anëtarë të obligueshëm të komisioneve vlerësuese.

3. Disiplina Profesionale:

- Siguron Komunën e Shtime se në pajtim me Ligjin Nr.08 L-012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në fushën e Ndërtimit do hap procedura disiplinore (pezullim licencash, paralajmërime) ndaj arkitektëve (anëtarëve të saj) që shkelin standardet gjatë shërbimit të tyre për Komunën;
- Njofton Komunën për shkelje të konstatuara.

2.2 Detyrat e Komunës së Shtime



1. Prokurimi dhe Transparenca:

- o Përfshin OARK-në në të gjitha fazat e prokurimit publik për projektet arkitekturore dhe të planifikimit urban;
- o Publikon dokumentacionin e konkurseve dhe vendimet në platformat zyrtare;
- o Ofron qasje në të dhëna dhe dokumente të rëndësishme planifikimin dhe zhvillimin hapësiror, lejet ndërtimore etj;

2. Zbatimi i Këshillave:

- o Aplikon kriteret e rekomanduara nga OARK-ja në tenderët , konkurset e projektimit apo lejet ndërtimore.
- o Merr në konsideratë rekomandimet e OARK-së për masat ligjore e procedurale apo ndërhyrje administrative nëse identifikohen shkelje të kontratave të saja për shërbime profesionale nga arkitektët.

3. Financat dhe logjistika:

- o Siguron hapësirat për punë të grupeve punuese;
- o Siguron materialet për punë dhe dokumentacionin e nevojshëm;
- o Konform realizimit të detyrave profesionale bartë shpenzimet e angazhimit të profesionistve nga radhët e OARK-së.

NENI 3 – METODAT E BASHKËPUNIMIT

3.1 Koordinimi dhe Komisionet

- Krijohet **Komisioni Koordinues** (3 anëtarë nga çdo palë) për:
 - o Monitorimin e zbatimit të Memorandumit.
 - o Zgjidhjen e mosmarrëveshjeve nëpërmjet dialogut.
 - o Organizimin e takimeve çdo 6 muaj.

3.2 Mjetet e Komunikimit

- o Platforma elektronike për shkëmbim dokumentesh.
- o Takime të planifikuara çdo 6 muaj + takime emergjente nëse lind nevoja.

NENI 4 – DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

1. Ky Memorandum hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga të dyja palët dhe mbetet në fuqi për një periudhë 5-vjeçare, me mundësi rishikimi sipas nevojës.
2. Çdo ndryshim apo shtesë në këtë Memorandum do të bëhet me marrëveshje të përbashkët me shkrim.



3. Palët angazhohen të zbatojnë këtë Memorandum me mirëbesim dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.
4. Çdo mosmarrëveshje që mund të lind nga interpretimi apo zbatimi i këtij Memorandumi do të zgjidhet me mirëkuptim dhe dialog mes palëve.
5. Palët nënshkruajnë këtë Memorandum Mirëkuptimi në dy (2) kopje të barasvlefshme, nga një për secilën palë.

Qemajl Aliu

Kryetar i Komunes

Nënshkruar më: 23/04/2025, Shtime



PALËT NËNSHKRUESE

Uran Kyçyku

Kryetar i Odës së Arkitektëve

